




Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarsvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës së Podujevës Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Emilija Redžepi, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 26.05.20 0-1102/04
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Edmond Kuka, Zyrtar për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Podujevës	
Lloji i aktit:	Rregullore	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës


I miratuar më datë: 22.05.20

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 26.05.20

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Ps:

Nga rregullorja ka ndryshuar vetëm neni që cakton datën kur rregullorja hyn në fuqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Nexhmi Rudari, zamenik gradonačelnika opštine Podujevo Fatmir Gashi, predsedavajući Skupštine opštine Podujevo	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS,	
Preko:	Emilija Redžepi, ministarka MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u,	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum: 26.05.2020. 0-1102/04
Sužbenik za potvrđivanje zakonitosti	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
Službenik za izradu pravne procene:	Edmond Kuka, službenik za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Podujevo	
Vrsta akta:	Uredba	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Uredba o izmeni i dopuni uredbe o upravljanju otpadom u opštini Podujevo
Usvojena dana, 22.05.2020. godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 26.05.2020. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta procenjuje da je opštinski akt sa proceduralnog aspekta u saglasnosti sa **zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi**.


Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

Ps:

U Uredbi izmenjen je samo član koji određuje datum kada Uredba stupa na snagu.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



MIA
9

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja c), 17 shkronja f), dhe 40.2 shkronjat a), g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 8 shkronja a), 15 shkronja f), dhe 19.1 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, dispozitave të neneve 15 dhe 34 të Ligjit për Mbeturina nr.04/L-060, nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe neneve 14, 15 paragraf 2.3, 11 paragraf 1.11, dhe 34 paragraf 2.1, 2.7, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 22 maj 2020, miratoi.

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Neni 12 paragrafi 2 i Rregullores nr.prot.01-352/11-0084561/19 të datës 30 tetor 2019 për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës, ku thuhet:

"Zbatimi i kësaj Rregulloreje fillon nga data 01 qershor 2020",

Ndryshohet, si vijon:

Zbatimi i kësaj Rregulloreje fillon nga data 01 qershor 2021

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës, si dhe në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.


Nr.01-352/04-0023112/20
Podujevë,
22 maj 2020



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujevo



SKUPŠTINA OPŠTINE

Shodno članova 11, 12.2 slovo c) 17 slovo f) i 40.2 slovo a), g) zakona lokalne Samouprave br.03/L-040, član 8 slovo a), 15 slovo f) i 19.1 zakona za Finansije i Lokalne Samouprave br.03/L-49 i člana, 15 i 34 Zakona o otpadu i objavu opštinskih akata i članova 14.15 st. 2.3, 11 i 34 st. 2.1, 2.7 Statuta Opštine Podujevo br.01-020/01-0050862/18 Skupština Opštine Podujevo na održanoj sednici dana 22 maja 2020 usvojila,

PRAVILNIK ZA IZMENE I DOPUNU PRAVILNIKA ZA POSLOVANJE OTPADOM U OPŠTINU PODUJEVO

Član 1

Član 12 st. 2, Pravilnika br.prot. 01-352/11-0084561/19 dana 30 oktobar 2019 za menadžiranje otpada u Opštinu Podujevo, gde se kaže:

"Primena ovog pravilnika počine od dana 01 juna 2020"

Menja se kao sledeće:

Primena ovog pravilnika počinje dana 01 juna 2021

Član 2

Po usvajanju ove predlog odluke i stupanja na snagu Primenu Odluke vrši Direkcija Budžeta i Finansije

Član 3


Odluka stupa na snagu 7 dana nakon objave u opštinskom službenom web sajtu i Službenom glasniku Republike Kosova.

Br. 01-352/04-0023112/20
Podujevo
22 maj 2020



Predstavljajući Skupštine
Zastupnik

Amir Gashi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së	
Përmes:		
Nga:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	Datë: 02/12/2019 Nr.0-1102/2
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Kujtim Aliu, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Podujevës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Podujevës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Rregullorja Nr. 01-352/11-0084561/19 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës, miratuar nga Kuvendi Komunal Podujevë

I miratuar me datë:30.10.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë:01.11.2019

I dërguar për shqyrtim në MMPH, me datë: 06.11.2019

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinën.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbetet në dispozicion të MAPL dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Vërejtje:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, konstatoi se Rregullorja Nr. 01-352/11-0084561/19 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës, miratuar nga Kuvendi Komunal Podujevë, është parashtruar për shqyrtim në MAPL, me datë 01.11.2019, ndërsa i njëjti është përcjellë në MMPH, datë 06.11.2019, andaj, si e tillë, akti i pranuar nga MAPL, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 9 paragrafi 2 nenparagrafi 2.1 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, ku shprehimisht thuhet: "Ministria, jo më vonë se dy (2) ditë nga data e pranimit të aktit të komunës, me shkresë përcjellëse do të adresoj aktin në ministrinë përgjegjëse për shqyrtimin e ligjëshmërisë".